



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01. Nr.06-350-10860/17
Kaçanik, 28.04.2017

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 10.2 dhe 10.3 të Ligjit 02/L-26 –Për Tokën Bujqësore, të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 –Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, të Propozim Vendimit të DUKMM 06Nr. 350-10860/17 – Për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore të Parcelës Kadastrale Nr. 02270-2 Arë e Klasës 4, në Zonën Kadastrale Kaçanik i Vjetër në emër të Sabri Gashi, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Prill 2017, mori këtë:

V E N D I M PARAPRAK PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS

1. Me këtë Vendim, merret Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të Tokës Bujqësore, në Tokë Ndërtimore, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe shfrytëzimit aktual (sipas Fletës Poseduese.
2. Toka me destinim Bujqësor e lejuar për ndërrimin e destinimit nga pika 1. e këtij Vendimi, lejohet në parcelën kadastrale **Nr. 02270-2 Arë e Klasës 4 (Katërt)** me sipërfaqe: **1000m²** e evidentuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-70917086-02270-2, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër në pronësi të Sabri Gashi, destinohet në Tokë Ndërtimore.
3. Parcelat Kadastrale si në pikën 2. të këtij Vendimi, ka destinim, Tokë Bujqësor, ndërkaq, destinohet në Tokë Ndërtimore dhe bëhet pjesë përkatëse e PZHK Kaçanik.
4. Para marrjes së vendimit përfundimtar për ndërrimin e destinimit të tokës së përcaktuar si në pikën 2 të këtij Vendimi, do të kërkohet, Pëlqimi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës -MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit- përmes kësaj drejtorie njoftohet pala dhe organet tjera relevante, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi